



REPUBLIKA E SHQIPERISË
BASHKIA KRUIJË
(NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK)

Nr. _____ Prot

Kruje me 18.11.2024

PROCESVERBAL- TIPI I KONTRATËS – SHËRBIME

ME

OBJEKT

‘MBIKQYRJA E PUNIMEVE TE NDERTIMI TË BASHKISE KRUIJË - IV-te’

LOTI I V : (“MBIKQYRJA E PUNIMEVE PËR OBJEKTIN SISTEMIM-ASFALTIM I RRUGËVE “HIDRI DHE SEJDINI ,FSHATI QEREKE NJ.A.NIKEL PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

I mbajtur sot me date 18.11.2024 ne Kruje prane Zyres se Prokurimeve , me qellim zbardhjen e procesverbalit te argumentimit dhe miratimit te kerkesave te vecanta per kualifikim dhe specifikimeve teknike per proceduren e prokurimit e llojit “E Hapur e Thjeshtuar” dhe ne referim te urdherit te **prokurimit nr.539 date 12.11.2024** , me te dhenat si vijon:

OBJEKTI I PROCEDURËS: Loti i V : (“Mbikqyrja e punimeve për objektin **Sistemim-asfaltim i rrugëve “Hidri dhe Sejdini ,fshati Qereke Nj.a.Nikel**
KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):Mbikqyrja e punës se ndertimit /(71521000-6)

- **VLERA E FONDIT LIMIT LOTI V-te: 188’937** (njqind e tetedhjetë e tete mije e nenteqind e tridhjetë e shtate) lekë pa TVSH

BURIMI I FINANCIMIT :Te ardhurat e Bashkise Kruje

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,i ndryshuar autoriteti/enti kontraktor Bashkia Kruje ka hartuar procesverbalin për argumentimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

Loti i V : (“Mbikqyrja e punimeve për objektin “**Sistemim-asfaltim i rrugëve “Hidri dhe Sejdini ,fshati Qereke Nj.a.Nikel**

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3; (Ne vleren prej 2% te fondit limit te lotit respektiv)

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

1-a)Operatori ekonomik nuk duhet te kete detyrime te taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe ato te vitit 2024 te njohura nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 “ Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2024 per secilin operator)

Shenim-Per te permbushur kete kriter ne fazen e ofertimit eshte e mjaftueshme paraqitja e deklarates, sipas shtojcës nr.9, ndersa operatori ekonomik i klasifikuar i pari, ne perputhje me nenin 26.6 te VKM Nr. 285, datë 19.5.2021 , duhet te dorezoje dokumentacionin provues si më poshtë :

- Vertetim per shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore perfshire edhe detyrimet vendore per vitin 2024 te leshuar nga ana e njesise vendore ku operatori ekonomik ka seline sipas QKB, ne rast se jane plotesuar afatet e maturimit te detyrimeve vendore per periudhen e mesiperme ne perputhje me kerkesat e ligjit nr 9632 date 30.10.2006 ‘’ Për sistemin e taksave vendore’’, i ndryshuar. (Edhe ne rastet e bashkimit te operatoreve duhet te kete vertetimin e shlyerjes se takses vendore 2024 per secilin operator).

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

a)-Kjo pikë përmbushet sipas pikës a) të Kriteve të Përgjithshme (Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9).

b) Ofertuesi duhet të jetë i pajisur me liçencë të vlefshme profesionale të shoqërisë dhe të drejtuesve teknikë, për Mbikqyrje dhe Kolaudim te Punimeve te Zbatimit , të lëshuar nga autoritetet kompetente shtetërore (sipas modelit te miratuar nga MZHU/MTI/MIE) me kategoritë e mëposhtme:

-NP-1→Punime gërmimi në tokë.

-NP-4→Rrugë, autostrada, ura, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.

-NS-6→Sinjalistikë rrugore jo ndriçuese.

-NS-18→Punime topogjeodezike.

Shenim –Licensa duhet te jete leshuar sipas rregullave te VKM nr.759 date 12.11.2014 “Per licencimin profesional të individëve dhe personave juridikë që do të ushtrojnë veprimtari në fushën e studimit e të projektimit në ndërtim dhe mbikëqyrjes e kolaudimit të punimeve të zbatimit në ndërtim” (Ndryshuar me VKM nr.943, datë 28.12.2016)

- *Shoqëritë e huaja, në lidhje me ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës, të zbatojnë legjislacionin shqiptar në fuqi*

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.a-Operatori/et Ekonomik duhet të paraqes/in kopje të deklaramit të xhiros vjetore per 3(tre) vitet financiare (2021'2022'2023) , ose vertetimin e lëshuar nga autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vleres e fondit limit te **kontrates/ lotit nr.5(për secilin prej loteve/ shumatores së loteve për të cilat konkurron)**”).

Shenim-Pika 2.2-a) plotësohet duke paraqitur vertetimin perkates te Administrates Tatimore .

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1-Përvojë e sukseshme në realizimin e të paktën:

a)Operatori ekonomik duhet te paraqese dëshmi për sherbime te mëparshme, të ngjashme me objektin e prokurimit, të kryera gjatë tri viteve të fundit nga data e shpalljes se njoftimit te kontrates **me një vlerë jo me te vogel se 20% e vlerës** së përlllogaritur të kontratës/lotit (**për secilin prej loteve / shumatores së loteve për të cilat konkurron**), që prokurohet .

Për të vërtetuar këtë Operatorët Ekonomik duhet të paraqesin:

- Kur furnizimi i shërbimeve te meparshme te ngjashme,është realizuar me institucione shtetërore,Operatori ekonomik do ta vërtetojë duke paraqitur vërtetimin e lëshuar nga Institucioni shtetëror për realizimin e sukseshëm të kontrates si dhe fatura tatimore të shitjes,të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruara nga të dyja palët.
- Kur shërbimet e meparshme te ngjashme është realizuar me subjekte private,Operatori ekonomik do ta vërtetojë këtë furnizim duke paraqitur vetëm faturën përkatëse tatimore te shitjes të plotësuar sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara,të nënshkruar nga të dyja palët.

2.4-a)Operatorët ekonomik në përgatitjen e ofertes së tyre ekonomike/financiare duhet ti referohen VKM nr.354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”, si dhe Rekomandimit të Agjencisë së Prokurimit Publik datë 25.07.2017, me Nr. 5585 Prot ”Mbi mënyren e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354,datë 11.05.2016” “Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin e territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” si dhe Rekomandimit te dates 27.06.2018 me nr 6559 prot te APP.

- **b)Shenim-**Mospërgatitja e ofertës sipas bazës ligjore të sipërpërmendur përbën shkak për skualifikim pasi ajo duhet te jete brenda kufijve te vleres minimale dhe maksimale te lejuar ne kuptim te nenit 7/1 te VKM nr 354,datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim” .

- Fondi limit i preventivit te zbatimit te objektit, “Sistemim-asfaltim i rrugëve “Hidri dhe Sejdiu ,fshati Qereke Nj.a.Nikel”, eshte 9.038,210.92 (nente milion e tridhete e tete mije e dyqind e dhjete pike nentedhete e dy) lekë pa t.v.sh,
- Reference per perlloraritjen e tarifes (fondit limit) per vleren e mbikqyrjes /kolaudim eshte perdorur Grupi Tarifor III sipas tabelës perkatese V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar ne njoftimin Nr. 5585 Prot. datë 25.07.2017 të Agjensisë së Prokurimit Publik ”Rekomandim mbi mënyrën e përcaktimit të tarifave minimale të specifikuara në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr.354 datë 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim”, dhe **VKM nr.610 date 22.09.2022**”Për përcaktimin e rregullave të detajuara për mënyrën e caktimit të mbikëqyrësit, detyrat dhe përgjegjësitë e tij, kushtet dhe elementet e përgjithshme të sigurimit të përgjegjësisë profesionale, si dhe rregullat, procedurat dhe mënyrën e mbajtjes së dokumentacionit gjatë zhvillimit të punimeve”.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike/termave te references

- Termat e References per proceduren respektive jane hartuar nga Drejtoria e Planifikimit te Territorit te Bashkise Kruje sipas te dhenave te shkreses me **nr.7965 Prot datë 12.11.2024** .Ne hartimin e tyre jane marre ne konsiderat kerkesat ligjore te fushes se planifikimit dhe zhvillimit te territorit , konkretisht Ligjit nr.107/2014 ‘Per Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’, normat perkatese te Ligjit nr. 9290 , date 7.10.2004 “Për produktet e ndërtimit” i ndryshuar dhe Vendim i KM nr.312, datë 5.5.2010 Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe kerkesat e Ligjit nr. 8402 datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar,udhezimit nr 3 date 15.02.2001 i KM ‘Per mbikqyrjen dhe kolaudimin e punimeve te zbatimit ne ndertim’ i ndryshuar
- Termat e References per sherbimin e mbikqyrjes , jane pjese e setit te dokumentave te ngarkuara ne SPE per proceduren respektive.
- **Fondi Limit i perlloratur per kete procedure eshte hartuar ne baze te V.K.M nr.354 date 11.05.2016 ”Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikimin të territorit, projektim, mbikeqyrje dhe kolaudim”.**, dhe jane marre ne konsiderate te tere elementet perberes te sherbimeve te domosdoshme per ekzekutimin e kontrates.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për shërbimet objekt prokurimi, që do të përfshihen në termat e referencës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 41, pika 1, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë

tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJESIA E PROKURIMIT PUBLIK

EGLANTINA SUBASHI

MELISA KUPA

MIKEDA CACA